

UDHËZIM
Nr. 5, datë 13.10.2020

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN,
MODIFIKIMIN OSE ANULIMIN E “CERTIFIKATËS SË PRANIMIT TË VEPRËS”
PËR PRODHUESIT ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
IMPIANTET QË PËRDORIN ENERGJINË NGA BURIME TË RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 11 dhe pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”,

UDHËZOJ:

Autoritetin Kontraktor të Ministrisë të ndjekë procedurat e mëposhtme për lëshimin e “Certifikatës së pranimit të veprës”, për të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike nga impiante që përdorin burime të rinovueshme, si më poshtë:

Neni 1
Përcaktime

Në këtë udhëzim, termat e përdorur të kenë të njëjtin përkufizim siç janë përcaktuar në ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“**Central prodhues**” është një tërësi godinash dhe impiantesh të caktuara, të cilat kanë si destinacion bazë prodhimin e energjisë elektrike.

“**Kodi**” janë sipas rastit: Kodi i Transmetimit, Kodi i Shpërndarjes dhe Kodi i Matjes, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe sipas miratimeve përkatëse të këtyre kodeve nga ERE, në kohën kur është miratuar e drejta e ndërtimit të centraleve prodhuese të energjisë elektrike që parashikon ky udhëzim.

“**Prodhimi i energjisë nga burime të rinovueshme**” është procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime të energjisë të rinovueshme nga një person i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike.

“**Njësi gjeneruese**” është pajisja, e cila shndërron drejtpërsëdrejti energjinë nga burime të rinovueshme në energji elektrike. Njësi gjeneruese, në kuptimin e këtij udhëzimi, është turbina hidraulike, moduli fotovoltai, turbina eolike etj., sipas specifikimeve teknike të prodhuesit.

“**Kapacitet i instaluar i impiantit**” është fuqia e energjisë elektrike, për të cilën njësi prodhuese është e aftë teknikisht të prodhojë, kur punon siç është fabrikuar, pa kufizime kohore, si dhe pa marrë parasysh ndërprerjet e vogla afatshkurtra. Kapaciteti prodhues i energjisë elektrike nga një impiant është i barabartë me kapacitetin e instaluar të njërive gjeneruese të marra së bashku.

“**Fuqia e instaluar e impiantit**” është shuma e fuqisë së instaluar të njërive gjeneruese brenda impiantit të transformimit të energjisë, karakteristika teknike e të cilave vërtetohet nga prodhuesi ashtu siç është parashikuar në dokumentet e specifikimeve teknike.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat, kushtet dhe afatet për lëshimin, dhe transferimin e certifikatës së pranimi të veprës (CPV).

Në përputhje me ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, prodhuesit me përparësi, të cilët kanë marrë certifikatën e pranimi të veprës të centralit elektrik, brenda datës 31 dhjetor 2020, kanë të drejtë të zgjedhin për të përfituar nga skema e mbështetjes, sipas kontratës për diferencë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji apo të vijnë me skemën e përfitimit sipas tarifave *feed-in*.

Neni 3

Objekti dhe fusha e veprimit

1. Certifikata e pranimi të veprës (CPV) është kërkesë e ligjit nr. 7/2017 dhe lëshohet nga ministria përgjegjëse për energjinë, sipas procedurave të parashikuara në këtë udhëzim.

2. CPV-ja dëshmon se subjekti ka realizuar gjitha kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të kontratës përkatëse për ndërtimin, rehabilitimin, transferimin dhe shfrytëzimin e burimit të rinovueshëm për prodhimin e energjisë elektrike që janë respektuar.

3. CPV-ja lëshohet në varësi të kategorisë së impiantit, si më poshtë përcaktuar:

a) CPV-ja konsiderohet e lëshuar automatikisht për të gjitha impiantet e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilat janë në operim dhe kanë kryer testimin e veprës para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2017. Për këtë kategori prodhuesish ekzistues me përparësi, CPV-ja i lëshohet në çdo rast shoqërisë koncesionare;

b) impiantet e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilat janë në operim dhe kanë devijuar nga fuqia e instaluar pas testimit të veprës dhe para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2017, duhet të informojnë Ministrinë për këtë ndryshim. Ministria, në bashkëpunim me strukturat e saj të varësisë, bën vlerësimin nëse një ndryshim i tillë është në përputhje me kushtet përkatëse të kontratës me subjektin dhe aplikon sipas rastit penaltete apo çdo lloj mekanizmi tjetër kontraktor ndaj subjektit. Në përfundim të këtij procesi, subjektit i lëshohet CPV-ja sipas fuqisë reale të instaluar;

c) CPV-ja lëshohet për të gjitha impiantet e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, të cilat janë në operim dhe kanë kryer testimin e veprës pas daljes së ligjit nr. 7/2017. Kjo kategori përfshin të gjitha llojet e impianteve që janë në operim nga prodhuesit ekzistues me përparësi për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme sipas përcaktimeve të ERE-s. CPV-ja lëshohet pasi është konfirmuar se marrëveshja (kontrata) e lidhur me këta prodhues ka respektuar procedurat ligjore, kushtet teknike për furnizimin/vendosjen e pajisjeve elektromekanike dhe hidroteknike, ofertën ekonomike, si dhe është e shoqëruar me një lejë ndërtimi, ka respektuar fuqinë e instaluar dhe është në operim ose ka përfunduar veprën.

Neni 4

Zbatimi

1. Ky udhëzim shërben për lëshimin e certifikatës së pranimi të veprës nga Autoriteti Kontraktues (AK) vetëm për prodhuesit që shfrytëzojnë burime energjie të rinovueshme, të cilët

janë përcaktuar sipas nenit 3. Këto kategori do të aplikojnë pranë AK-së për të përfituar CPV vetëm pasi të jenë pajisur me një nga këto dokumente:

- të jenë mbajtës të miratimit për ndërtimin e veprës; ose
- të kenë nënshkruar kontratë koncesionare dhe/ose një kontratë të vlefshme me AK-në.

2. Autoriteti Kontraktor, nisur nga strukturat përgjegjëse për monitorimin, është përgjegjës për të konfirmuar vërtetësinë e dokumentacionit për statusin e ndërtimit sipas kërkesave të këtij vendimi. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, duhet të paraqitet nga prodhuesi ekzistues me përparësi në çdo rast gjatë aplikimit për CPV në Ministri.

3. Certifikata e pranimit të veprës verifikon:

a) Nëse parametrat teknikë të centralit gjenerues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme janë respektuar sipas parashikimeve kontraktuale. Mes të tjerash, parametrat teknikë verifikohen që të përputhen për njësinë gjeneruese, e cila shndërron drejtpërsëdrejti energjinë e rinovueshme (turbina hidraulike, moduli ose modulet fotovoltaike, turbina eolike etj.) në energji elektrike.

Centrali në përgjithësi mund të përbëhet nga një numër i kufizuar (një dhe/ose më shumë) njësi gjeneruese dhe për të përcaktuar fuqinë e instaluar të tij është e domosdoshme të mblidhet fuqia e instaluar e secilës njësi gjeneruese që e përbëjnë centralin. Në kuptimin e këtij udhëzimi, kjo fuqi e instaluar njihet si kapaciteti gjenerues ose si kapaciteti i instaluar brenda një kontrate të lidhur me AK-në;

b) Nëse ka një raport të testimit të veprës, të lëshuar nga personat zyrtarë të pranishëm në testim, sipas kontratës me AK-në, përfshirë procesverbalet teknike të pranuar nga palët në testim, si dhe adresën se ku është përpiluar ky raport. Raporti i testimit duhet të jetë origjinal ose i vërtetuar me origjinalin dhe duhet të përfshijë mes të tjerash vendndodhjen e veprës dhe të jetë kryer sipas procedurave të kohës kur është përpiluar;

c) Nëse ndërtimi certifikohet nëpërmjet aktit të kolaudimit të mbajtur në bazë të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar;

d) nëse centrali prodhues është lidhur me rrjetin elektrik sipas një procedure për lidhjet e reja, i ndryshuar, si dhe është në përputhje me rregullat e lidhjes së tij me sistemin elektroenergjitik, Kodin e Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve, Kodin e Matjes, si dhe akteve të tjera në fuqi.

Neni 5

Aplikimi dhe kërkesat për certifikatën e pranimit të veprës

1. Kërkesa për certifikatën e pranimit të veprës së centralit elektrik mund të paraqitet për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, i cili ka përfunduar procesin e testimit dhe të kolaudimit të veprës në përputhje me parashikimet ligjore dhe kontraktuale dhe është energjizuar (ka një kontratë) me OST/OSSH.

2. Çdo prodhues, i cili dëshiron të pajiset me certifikatën e pranimit të veprës së centralit elektrik (aplikues), paraqet pranë Autoritetit Kontraktues/ministrit një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të dhënat dhe dokumentacionin në format *hard copy* dhe CD, si më poshtë:

i. të dhënat teknike dhe specifikimet e centralit elektrik:

- a) burimin e rinovueshëm të energjisë, nga i cili prodhohet energjia elektrike;
- b) datën e autorizimit të impiantit dhe datën kur është futur në punë;
- c) kontratën për blerjen e energjisë;
- d) prodhimin vjetor dhe/ose prodhimin mujor aktual duke filluar nga data e fillimit të prodhimit dhe/ose të lidhjes me rrjetin e OST/OSSH deri në muajin që aplikon për CPV-në;

e) Paraqitjen e përgjithshme skematike të imiantit në format A1 ku të dallohen qartë karakteristikat teknike të pajisjeve për transformimin e energjisë së rinovueshme në energji elektrike. Paraqitja e diagramit të lidhjeve elektrike dhe skema elektrike ku identifikohen daljet nga njësia gjeneruese deri te pajisjet invertuese, transformuese, kontrolluese dhe matëse të sasisë së energjisë që hidhet në rrjetin e transmetimit dhe/ose të Shpërndarjes të energjisë elektrike.

ii. dokumentacioni shoqërues i aplikimit për CPV përmban:

a) kontratën e nënshkruar ndërmjet koncensionarit dhe/ose mbajtësit të miratimit dhe autoritetit kontraktor (AK-ja ose OSHA-ja), si dhe të gjitha ndryshimet e mundshme të saj deri në formën ligjore përfundimtare;

b) të dhënat tregtare të shoqërisë koncesionare;

c) raportin përfundimtar për realizimin e investimit dhe plotësimin e detyrave dhe detyrimeve kontraktore për veprën gjeneruese të firmosur ndërmjet palëve kontraktore, nëse ka;

d) licencën e lëshuar nga ERE për fuqinë e instaluar të centralit;

e) projektin e miratuar nga Autoriteti Kontraktor me të gjitha ndryshimet mbi të cilin është dhënë e drejta për ndërtimin e impiantit;

f) çdo miratim tjetër të dhënë nga AK-ja të shoqëruar me një kontratë të vlefshme.

iii. leja e ndërtimit dhe miratimi për lidhjen me sistemin elektroenergjetik;

iv. dokumentacioni për përfundimin e ndërtimit të veprës përfshin mes të tjerash edhe:

a) certifikatën e kolaudimit dhe listën e dokumenteve si pjesë e dosjes (firma: kolaudatori dhe mbikëqyrësi);

b) raportet e testeve të impiantit dhe/ose testet e performacës në prezencë të Autoritetit Kontraktor ose sipas parashikimeve të kontratës;

c) manualet dhe pasaportat e makinerive dhe të pajisjeve kryesore (patjetër turbinë, gjenerator, transformatorë të fuqisë dhe në rastin e FV-së, moduli, inverteri dhe trafo);

d) protokollet e matjeve të sistemeve të mbrojtje-tokëzim ndaj goditjeve dhe shkarkimeve atmosferike, goditjeve elektrike mbi makineri-pajisje etj.

Neni 6

Procedurat për lëshimin, transferimin dhe refuzimin e certifikatës së pranimi të veprës

1. Ministria, mbështetur në kërkesën e prodhuesit ekzistues me përparësi (aplikuesi), fillon menjëherë procedurën për shqyrtimin e kërkesës për pajisje me certifikatën e pranimi të veprës pasi ajo është protokolluar dhe është shoqëruar me dokumentacionin sipas këtij udhëzimi pranë Ministrisë.

2. Aplikuesi duhet të paraqesë, mes të tjerash, një NID, një adresë elektronike të vlefshme dhe të shoqërojë aplikimin me një listë dokumentesh për përmbajtjen e dosjes së aplikimit. Me aplikuesit do të komunikohet zyrtarisht nëpërmjet postës zyrtare elektronike të nëpunësit civil të ngarkuar për shqyrtimin e dosjes. Ministri miraton një grup pune me të paktën 4 specialistë dhe 1 drejtor, që kryeson grupin, të përfaqësojë AK-në në këtë procedurë.

3. Ministria, në çdo rast, i bën me dije aplikuesit, nëpërmjet postës elektronike, pranimin apo refuzimin e kërkesës për mangësitë në dokumentacionin e kërkuar në këtë udhëzim, jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e depozitimit të aplikimit.

4. Ministria mund të kërkojë çdo sqarim, si dhe të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për palët në proces. Pas përfundimit të komunikimit për pranimin dhe/ose refuzimin e kërkesës përpilohet një procesverbal i firmosur nga nëpunësit civilë dhe aplikanti. Ky procesverbal zbardhet nëpërmjet komunikimit zyrtar me *hard copy* dhe me shkresë përcjellëse nga Ministria i dërgohet aplikuesit.

5. Pas njoftimit të fillimit të procedurës së shqyrtimit sipas këtij udhëzimi, brenda 30 ditëve, Ministria shqyrton aplikimin dhe informon kërkuuesin për vendimin e Autoritetit Kontraktues mbi lëshimin e certifikatës së pranimit të veprës ose refuzimin e kërkesës së tij.

6. Brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 4, të këtij neni, Autoriteti Kontraktues merr vendim, për:

- lëshimin e certifikatës së pranimit të veprës së kërkuar, i cili regjistrohet në regjistrin elektronik të certifikatës së pranimit që mbahet nga Autoriteti Kontraktues;

- refuzimin e lëshimit të certifikatës së pranimit të veprës në rast se subjekti nuk përmbush kërkesat e nevojshme, procedurën apo dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

7. Ministria, në rast të refuzimit të kërkesës, do t'i bëjë të ditur vendimin e refuzimit aplikantit. Vendimi i refuzimit përmban arsyetimin në bazë të të cilit Ministria refuzoi aplikimin.

8. Kur Ministria konstaton se kërkesa për pajisje me certifikatën e pranimit të veprës e paraqitur nga aplikuesi nuk përmban dokumente të rëndësishme, të cilat e pengojnë Ministrinë në verifikimin e përmbushjes së kriterëve të këtij udhëzimi, Ministria specifikon që dokumentacioni është jo i plotë dhe mund të lëshojë një certifikatë me kusht. CPV me kusht lëshohet kur aplikanti nuk ka paraqitur një raport të verifikuar nga organet tatimore për vlerën e objektit.

9. Ministria mund të refuzojë lëshimin e certifikatës së pranimit të veprës kur ka dyshime të bazuara për saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e dokumentacionit.

10. Ministria mund të vendosë, rast pas rasti, për zgjatjen e afatit të përcaktuar në paragrafin 4, të këtij neni, kur vlerëson se dokumentacioni nuk është i plotë. Në çdo rast zgjatja e afatit nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë. Ministria specifikon dokumentet që mungojnë ose janë jo të plota, të cilat duhet t'i paraqiten nga subjekti kërkuar brenda 15 ditëve në vijim. Në vijim të analizës së dokumentacionit shtesë, kërkesa mund të pranohet ose refuzohet. Nëse dokumentacioni i munguar apo shtesë nuk dërgohet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit nga Autoriteti Kontraktues, kërkesa refuzohet për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit të nevojshëm.

11. Ministria kur e sheh të arsyeshme mund të kërkojë verifikimin e çdo informacioni të nevojshëm nga organet kompetente, duke vënë në dijeni kërkuuesin për këtë.

12. Në rast se Ministria refuzon kërkesën për pajisje me certifikatën e pranimit të veprës, aplikuesi mund të paraqesë një kërkesë të re, duke marrë në konsideratë udhëzimet e Autoritetit Kontraktues.

Neni 7

Vlefshmëria e aplikimeve të mëparshme për lëshimin e certifikatës së pranimit të veprës

1. Në të gjitha rastet, kur midis AK/OSHA dhe subjektit kontraktor është realizuar kontrolli dhe certifikimi i investimit të njësisë gjeneruese, atëherë ky aplikim konsiderohet i vlefshëm dhe duhet të riparaqitet në formën e njehsuar me të gjitha materialet që i janë bashkëlidhur “Raportit përfundimtar për realizimin e investimit dhe plotësimit të detyrave dhe detyrimeve kontraktore për njësinë gjeneruese...”. Subjekti kontraktor paraqet dokumentacionin sipas këtij udhëzimi dhe bën plotësimet e nevojshme.

2. Kërkesa e aplikuesit në këtë rast shqyrtohet dhe trajtohet njësoj si kërkesëaplikimet e reja, sipas këtij udhëzimi.

Neni 8

Lëshimi dhe formati i certifikatës së pranimit të veprës

Nëse Ministria vlerëson se Aplikanti plotëson kriteret e përcaktuara dhe ka paraqitur prova të kënaqshme dokumentare në përputhje me këtë udhëzim, lëshon certifikatën e pranimit të veprës.

CPV-ja lëshohet në 3 kopje dhe nënshkruhet nga ministri ose nga nëpunësi i autorizuar nga ministri. Format i certifikatës së pranimit të veprës përmban të dhënat si më poshtë:

- a) numër protokollit dhe datën e kontratës dhe shtesave të kontratës të lidhur me AK-në ose OSHA-në;
- b) burimin e energjisë, nga i cili prodhohet energjia;
- c) fuqinë e instaluar të centralit të shprehur në *kW* ose *kVA* për fotovoltaiKET;
- d) datën e fillimit dhe të përfundimit të ndërtimit të centralit;
- e) datën e fillimit të prodhimit (sipas kontratës);
- f) emrin, vendin, tipin dhe kapacitetin e impiantit;
- g) prodhimin e parashikuar sipas kontratës dhe prodhimin vjetor/mujor deri në muajin e lëshimit të CPV-së;
- h) emërtimin e pikës së lidhjes me rrjetin elektroenergetik;
- i) numrin e licencës të lëshuar nga ERE, numrin e kontratës të blerjes me OSHEE-në;
- j) vlerën e investimit neto të centralit;
- k) numrin e marrëveshjes të nënshkruar me KESH/OSHEE/FTL.

Neni 9

Ndryshime në detajet teknike të modifikuara

1. Çdo modifikim i ndodhur në impiantet prodhuese të energjisë në përputhje me certifikatën e lëshuar të pranimit të veprës, duhet të ketë paraprakisht miratimin e Autoritetit Kontraktues, si dhe çdo miratim tjetër të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse për lëshimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

2. Në çdo rast për të verifikuar saktësinë e të dhënave të depozituara, Ministria ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë apo dhe të monitorojë në vend impiantin prodhues.

Neni 10

Transferimi dhe anulimi i certifikatës së pranimit të veprës

1. Ministria, në çdo rast që merr dijeni për shkelje të kushteve thelbësore, për të cilat është dhënë certifikata e pranimit të veprës, ndjek procedurat e anulimit të certifikatës së pranimit të veprës, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

2. Certifikata e pranimit të veprës mund të transferohet, në rast ndryshimi të administrimit të shoqërisë koncesionare që mbart emrin sipas kontratës.

3. Në rast se modifikimi i detajeve teknike të miratuara nga AK-ja sipas nenit 8 e bën projektin të përputhshëm me kërkesat e kësaj rregullore, certifikata e pranimit të veprës lëshohet sërish në përputhje me modifikimet e bëra.

Neni 11

Inspektimet teknike

Për të siguruar përmbushjen e kushteve të lëshimit të pranimit të veprës dhe se të dhënat, mbi të cilat është lëshuar ajo, janë të sakta, përfaqësuesit e MIE-s dhe çdo person i autorizuar prej saj, kanë akses të lirë në impiantin përkatës të prodhimit dhe në të gjitha të dhënat dhe informacionin për impiantin në fjalë.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku